

OSBE Misioni në Kosovë dhe  
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime Politike

---

Konferencat për Diskutimin e Agjendave Publike të Kosovës  
Seria e tryezave për reformë institucionale dhe qeverisëse:  
Reforma e qeverisjes lokale – Seanca Nr. 2

# Kërkimi i modeleve: Krijimi i rekomandimeve

**Raport**

Nga Leon MALAZOGU, Drejtor i programit i KIPRED-it

16-18 Shkurt 2003  
Prishtinë, Kosovë

*Aq më shumë që diskutojmë, aq më pak do të kemi frikë në këtë proces. Ndoshta ka qenë një gabim, ndoshta ka ka qenë e parakohëshme, por shikoni ku jemi sot! Ne jemi një grup intelektualësh, administratorësh, shkollarësh, duke u munduar të identifikojmë zgjidhjet më të mira dhe më optimale për çështje të ndërlidhura me decentralizimin dhe reformën e qeverisjes lokale. Kujtoni se në fillim është thënë se nivelet e demokratizimit duhet t'a paraprijnë demokratizimin. Nëse e kuptojmë konceptin e demokratizimit si të tillë, ne duhet të kuptojmë se kjo na bën neve më demokratik nga brenda. Ne i kemi disa opsione në tavolinë. Ne u frikësuam se do të përfundojmë pa ndonjë opcion. Në fakt, ne kemi diçka tani. Shpresa ime është që në raundin e tretë, ne do të jemi në gjendje të kemi diçka; ndoshta disa iniciativa për politika (Kryesuesi).*

## DUKE HAPUR DEBATIN PUBLIK

Në fund të vitit 2002, PSSP lansoi një iniciativë për të decentralizuar dhe reformuar qeverisjen lokale. Reforma e qeverisjes lokale është një proces serioz që duhet të kalojë nëpër një diskutim të brendshëm të akademikëve kosovarë dhe të huajë. Kjo tryezë e rrumbullakët ka përfshirë akademikë dhe profesionistë të etniciteteve të ndryshme nga Kosova si dhe ekspertë dhe profesionistë rajonal dhe ndërkombëtarë. Ekziston nevoja që debati publik dhe procesi politik të mbështetet me diskutim të pavarur shkencor për të identifikuar çështjet substanciale, për të ofruar këshilla profesioniste dhe akademike në kornizimin e alternativave dhe kështu për të ndihmuar një diskutim gjithëpërfshirës për zgjidhjet më të mira për Kosovën.

Raundi i parë i diskutimeve mbledhi një grup akademikësh në dhjetor 2002 me qëllim që të ngriten pyetjet e duhura dhe të identifikohen problemet e duhura në të gjitha nivelet<sup>1</sup>. Duke vazhduar me debatin, Departmenti i Demokratizimit i OSBE-së Misioni në Kosovë dhe Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave organizuan një raund të dytë të debatit të ekspertëve mbi reformën e qeverisjes lokale. Synimi final i këtij raundi ishte që të hapet një debat publik duke zhvilluar dhe analizuar opsione të ndryshme në suaza të gjëra, që ishte arritur. Në këtë aspekt, ai raund analizoi problemet që duhet të adresohen duke shikuar situatën në terren, teorinë e qeverisjes lokale, ekspertizën lokale, dijeninë historike dhe përvojën praktike të udhëheqjes së komunave kosovare. Projekti synoi të influencojë agjendën publike duke ofruar ekspertizën e nevojshme në këtë aspekt. OMIK dhe KIPRED janë të gatshëm të vazhdojnë me këtë seri të diskutimeve në bashkërendim të ngushtë me Këshillin e Europës dhe sipërmarrësit e tjerë. Asociacioni i komunave mendon se konferenca e parë ka sjellur një përfitim të madh për procesin (Haziri).

## PRESIONI I QEVERISJES LOKALE

Me vendosjen e administratës së UNMIK-ut në Kosovë, qeverisja në nivel lokal ishte e rregulluar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45. Sidoqoftë, ka pasur presion në rritje prej atëherit për zhvillim të mëtejshëm të bazës legjislative për vetë-qeverisje lokale me qëllim që të shpejtohet procesi i demokratizimit dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë. Siq tha Ambasador Fieski, kryesues i OMIK-ut, pritjet e popullatës për një qeverisje lokale efikase ende po rriten. Asociacioni i Komunave, poashtu “beson se reforma e qeverisjes lokale duhet të ndodhë në një nivel më të ulët me qëllim që të përmirësohet qeverisja lokale” (Haziri). Haziri poashtu përmendi konfliktin për kompetenca që po rritet që kishte shkaktuar kaos në shërbimet që duhej t'u ishin dhënë qytetarëve.

## QËLLIMI

Siq u tha në raportin e fundit, kjo çështje doli në pah “kur PSSP paraqiti planin shtatë pikësh për Mitrovicën<sup>2</sup>, me synimin për t'i motivuar serbët që të marrin pjesë në zgjedhjet lokale që po afroheshin në atë kohë”. Siq tha një pjesëmarrës ndërkombëtarë, veçmë kishte pasur propozime që vinin nga Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar, dhe asnjë nga ndonjë institucion kosovar. Duhet të vërehet se udhëheqësia kosovare kane qenë skeptik ndaj çfarëdo iniciative që ka pasur decentralizimin si qëllim. Sidoqoftë, me synimin preciz për të mënjeluar politizimin e tepërt dhe duke dashur të lansojnë një proces që është i dobishëm në gjithë

<sup>1</sup> Raporti nga tryeza e parë rekomandohet si informacion shtesë dhe është në dispozicion ose tek OMIK ose tek KIPRED tek [www.kipred.org](http://www.kipred.org)

<sup>2</sup> “Një zgjidhje për Mitrovicën” në Tetor 2002 një javë para zgjedhjeve lokale.

Kosovën, pjesëmarrësit në tryezën e parë të rrumbullakët vendosën të ndryshojnë titullin e konferencës nga Decentralizimi në Reformë të Qeverisjes Lokale. Synimi i përgjithshëm i tryezës së dytë ishte kërkimi i modeleve për të sjellur qeverisjen më afër njerëzëve. Qeverisja lokale duhet të reformohet dhe të sjellet me afër njerëzëve, dhe duhet të jetë efikase, përgjegjëse e përgjegjshme ndaj njerëzëve, siq tha Ambasador Fieschi, Kryesues i OMiK. Zgjidhja e problemeve etnike është vetëm njëri nga synimet, shtoi ai. Frischenschlager, Drejtor i Demokratizimit, theksoi se ka probleme në nivelin lokal që duhet të zgjidhen dhe me to duhet të mirremi në një mënyrë të përgjithshme. Kjo tryezë ishte dizajnuar si një forum për të analizuar mundësitë për devolucionin dhe çfarë mund të zhvillohet tek niveli lokal. Duke e theksuar aspektin e përgjithshëm poashtu, Ministri i Shërbimeve Publike poashtu theksoi se decentralizimi ishte vetëm një pjesë e vogël e një procesi të përgjithshëm të reformës së qeverisjes lokale.

Megjithë ndryshimin e fokusit nga decentralizimi si i tillë tek reforma e qeverisjes lokale në përgjithësi, kishte zëra skeptik që dëshironin të rishikojnë qëllimin e gjithë tryezës së rrumbullakët: “Duhet të jetë e qartë çka dëshirojmë të arrijmë, a është një epizodë politike apo qeverisje efikase? Ne mendojmë se ky është një proces politik dhe se çështja etnike është shtysa kryesore në këtë proces”. Sipas një pjesëmarrësi, bregat kryesore të komunave ishin arritja deri tek një definim i kompetencave në mes niveleve lokale dhe qendrore. Reforma u vlerësua e nevojshme, por jo e bazuar në dinamikën e pushtetit prezente në këtë kohë. Për disa, kjo çështje nuk është prioritet për Kosovën, e cila sipas këtij pjesëmarrësi edhe ashtu nuk e ka kapacitetin t’i implementojë këto modele të idealizuara. Duhet të mirret para sysh se 50% e popullatës janë ende nën nivelin e varfërisë kur bëhen modele. Për tjerë, edhe pse kjo ka mundur të mos jetë prioriteti më i lartë, pasi që ishte vendosur në tavolinë përmes virtytit të politikës, kosovarët duhet t’a shfrytëzojnë atë më së miri.

Tryeza e rrumbullakët poashtu pat një ndikim në të menduarit e Zyrës së PSSP-së. Siq tha Minna Järvenpää, këshilltare e PSSP-së, “Në fillim, kishte një nocion të fiksuar për atë se si mund të dukej decentralizimi. Tash, ne kemi shumë më shumë ide. Këshillit të Europës i është dhënë mandati për t’i shqyrtuar të gjitha opsionet e mundshme”. Ajo i arsyetoi pushtetet e jashtëzakonshme me situatën emergjente, dhe premtoi se do të ketë një trend të rënies në këtë aspekt.

Qëllimi i përgjithshëm i tryezës së parë të rrumbullakët ishte të:

### 1. Krijojë një ambient për politikë-bërje të mirë

(a) Një model të tentimeve për t’a bashkuar ekspertizën dhe të promovimit të një lloji të të menduarit që do të krijojë një ambient që do të ofrojë politikë-bërje të mirë;

(b) Vendosë këto propozime në tavolinat e politikanëve kështu që ata do të mund t’i merrnin parasysh ato përjashta këtij ambienti emocional.

**2. Nxjerrë çështjen e decentralizimit jashtë qasjes legalistike/Balkanistike** që është modeli për rajonin. Tryeza synonte poashtu të shtojë aspekte tjera: kulturor, historik, dhe çfarë mund të bëhet për t’a bërë këtë proces më efektiv. Pasi që çështja ishte shumë politike me fillim, qëllimi ishte që të nxjerret ky proces jashtë kësaj arene, të vendoset në duar të ekspertëve dhe pastaj të sjellet prapë në duar të politikanëve dhe t’iu ofrohet atyre një model i ri (prapë, jashtë qasjes legalistike).

**3. Procesi i identifikimit.** Tryeza e rrumbullakët e mëhershme e la hapur pyetjen se cili nivel do të decentralizohet më tej. Ne poashtu e lamë atë të hapur për çështje të financave, një çështje e lënë për tryezën e dytë dhe të pastajmet.

## NJË BASHKËPUNIM I AKADEMIKËVE DHE PROFESIONISTËVE

Seria e konferencave deri më tani ka mbledhur kryesisht akademikë dhe gradualisht është hapur ndaj profesionistëve dhe zyrtarëve qeveritarë. Tryezat janë të mbyllura për mediat me qëllim që të sigurohet një atmosferë të relaksuar dhe të parandalojë pozicionime politike të pjesëmarrësve. Synimi ishte të krijohen komente të mjaftueshme për Këshillin e Europës.

Tryeza filloi me pikëpamje ekspertësh mbi temën me qëllim të themelimit të një qasjeje diçka më të depolitizuar drejt temës veçmë senzitive. Një ekspert nga një organizatë ndërkombëtare paraqiti një përmbledhje mbi sistemin e komunave në Kosovë prej pas Luftës së Dytë Botërore deri tek sfidat e tashme të ndeshura sot, nga një perspektivë ligjore dhe institucionale. Një perspektivë teorikë iu shtua nga një profesor nga rajoni. Pikëpamja institucionale u paraqit nga zyrtarët qeveritarë dhe të UNMIK-ut të pranishëm, derisa problemet e përditshme ishin artikuluar shumë mirë nga tre kryetarët e komunave të pranishëm. Institucione

publike relevante prezentuan në seancën e dytë, Zyra e PSSP-së, Ministria e Shërbimeve Publike, Drejtorati i Qeverisjes Lokale dhe Këshilli i Europës si institucioni që i ishte dhënë roli udhëheqës në këtë aspekt. Tryeza e rrumbullakët ishte e moderuar nga shefi i Departmentit të Shkencave Politike të Univerzitetit të Prishtinës, që iu shtua barrëmbajtjes së procesit nga të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë. Eksperti kryesor ndërkombëtarë i ftuar, Marcus Brand, tha “Nuk mendoj se ka ndonjë grup më të mirë institucional për të promovuar një lloj të tillë të reformës apo debatit”.

## SFIDA

Katër çështje paraqitën një sfidë madhore për analizimin e kësaj teme në një nivel më të thellë: vështirësia për të krijuar një pamje ligjore të ndarjes së kompetencave, mungesa e rezultateve të konsoliduara të hulumtimeve mbi atë se çfarë po ndodhë në terren, motivet politike mbrapa idesë, dhe mungesa e ekspertizës për të identifikuar pasojat ekonomike dhe financiare të modeleve të ndryshme.

Përshtetimi i kompetencave të tashme është një detyrë e lodhshme. Një perspektivë legalistike është shumë komplekse dhe poashtu është lufta për të marrë disa detyra e për t'i lënë tjerat. Komunitat ankohen se 2000/45 nuk siguron qeverisje komunale kuptimplote dhe se shumë pak nga 23 detyrat e përmendura aty u janë lënë në të vërtetë atyre që t'i implementojnë. Në anën tjetër, disa përgjegjësi që u janë lënë komunave nuk janë kryer ose për shkak të mungesës së vullnetit ose për shkak të mungesës së kapacitetit për t'i implementuar ato. Shpesh, qasja legjislative nuk është përshtatur për t'i implementuar këto kompetenca pasi që komunitat nuk mund të paguanin për to. Poashtu, sipas Brand, ekziston një përdorim jokonistent i termit “kompetencë” në tekste të ndryshme legjislative siq është 2000/45 si dhe në kornizën kushtetuese.

Për kosovarët, decentralizimi ishte një frustracion pasi që nuk ka ndonjë ndarje të qartë të kompetencave në nivelin qendror. Shumë e kanë kritikuar këtë ide mbi baza politike dhe e kanë quajtur “e nxituar dhe e pastudiuar mjaft”. Shumica e kosovarëve kanë menduar se është një humbje kohe për të folur për këtë proces pa e konsoliduar nivelin qendror të pushteteve kosovare. Në çdo rast, ka pasur një marrëveshje të gjërë që të aktivizohen zyrat e komuniteteve lokale. Kritikant poashtu kanë ardhur nga aspekti ekonomik. Edhe pse kjo është një çështje shumë emocionale dhe e politizuar, nuk do të thotë se nuk ka asnjë qasje racionale të mundshme. Siq thekson Frischenschlager “ne nuk jemi të interesuar vetëm në ndarje të pushtetit, por ne jemi të interesuar në një zgjidhje racionale”.

## POZITAT ZYRTARE

Zyrtarët qeveritarë në përgjithësi u shprehën se janë për decentralizim, sidoqoftë, ky proces do të duhej të ndërmerrej pas kërkimeve të gjëra ligjore, institucionale dhe në terren. Një zyrtarë ndërkombëtarë më vonë theksoi se institucionet kosovare nuk kanë pasur iniciativë përballë dy dokumenteve të nxjerra nga Qendra e Koordinimit e Serbisë/RFJ-së dhe administrata ndërkombëtare.

Kishte poashtu debate metodologjike se a duhet të preken çështjet politike dhe etnike qysh në fillim si burimet kryesore pse kjo temë po debatohet në këtë kohë, ose se a duhet të kihet një qasje më e butë. Çështjet politike në të vërtetë ishin diskutuar mjaft hapur më vonë, dhe shumë pjesëmarrës deklaruan se pas disa procedimeve me konferencën, ata u ndjenë shumë rehat duke diskutuar madje edhe patatet më të nxehta në tavolinë. Një pjesëmarrës madje tha se dinamika e konfliktit prej të cilit Kosova është shkatërruar pikë së pari është prezente ende deri në një masë dhe se situata është prapë në nivelin e vitit 1990.

## PËRPUTHSHMËRIA ME KARTËN EUROPIANE TË VETË-QEVERISJES

Pjesëmarrësit u pajtuan se çfarëdo reforme e qeverisjes lokale në Kosovë duhet të bëhet sipas Kartës Europiane për Vetë-Qeverisje (KEVQ) si një udhëzues. Sidoqoftë, kishte një numër çështjesh që ende mbetet të qartësohen. Pyetja kryesore ishte si të përdoret KEVQ si bazë për punë dhe të përshtatet ajo me situatën momentale në Kosovë. Brand vlerësoi se KEVQ është adoptuar veçmë në shumë vende me tradita të ndryshme të qeverisjes lokale dhe ka pasur “një ndarje substanciale në çdo gjë që ju takon atyre”, pra, ka qenë shumë e gjërë. Modelet e shkencave politike vetëm mund të na e zgjerojnë spektrin tonë, por nuk ka ndonjë shkurtesë të lehtë për të gjetur një model specifik për atë (Brand).

## PËRFUNDIMET KRYESORE TË TRYEZËS SË RRUMBULLAKËT

Përfundimet kryesore të tryezës ishin si në vijim:

- Decentralizimi nuk mund të ndodhë përgjatë vijave etnike, edhe pse është një kriter me rëndësi.
- U sugjerua të krijohet një grup punues me Këshillin e Europës ku të gjithë pjesëmarrësit do të participonin dhe përfaqësuesi i Këshillit të Europës u përkushtua që të ftojë këta përfaqësues së shpejti.
- Asnjë proces i decentralizimit nuk mund të ndodhë pa përkrahjen e shumicës kosovare.
- Një tipologji në vija të trasha e tre modeleve që u ofruan është paraqitur më poshtë:

MODELI I: 30	MODELI II: PRISHTINA +	MODELI III: 30+
Kryesisht e mbështetur nga shqipëtarët e Kosovës. P.sh. Gjilani dhe Prizreni si komuna që funksionojnë mirë ku pakicat janë të përfaqësuara mirë; në Gjilan nuk ka asociacione të komuniteteve, por zyra të decentralizuara.	Krijimi i një lloji të njësive nën-komunale; pjesë që nuk janë të integruara formalisht në shërbimin komunal.  Seksioni 5+ (i Rregullore 2000/45) që i jep komunës autoritetin për të krijuar njësi nën-komunale, por nuk shkon aq larg sa të krijojë komuna të reja	Komunat e Shtërpçës dhe Shtimes.  Modeli slloven: për shkak se Sllovenia ka shkuar kësaj rruge, duke e ndarë qartë qeverisjen Lokalë dhe administratën e decentralizuar shtetërore.  çështja e kriterëve se si do të krijoheshin komuna të reja ose metoda se si kjo do të duhej të bëhej.

Eksperti ndërkombëat që e moderoi seancën finale përfundoi se vetëm modeli i dytë dhe i tretë do të ishin të përputhshëm me Kartën Europiane për Vetë-Qeverisje.

Duke u bazuar në modelin e mësipërm, u identifikuan tri mënyra se si të shkohet përpara:

- Qëndrimi pranë Rregullores 2000/45 mbi komunat dhe fokusimi në përmirësimin e byrokracisë, qartësimi i kompetencave dhe gjetja e një vije të re në mes nivelit qendror dhe komunal, edhe pse duke e mbajtur atë kryesisht në pajtim me 2000/45.
- Qëndrimi pranë 30 komunave, por duke mësuar se cilat kompetenca të nivelit komunal mund të transferohen tek një nivel më lokal, nën-njësi të 30 komunave, kjo duke qenë një ide për t'a jellur popullatën më afër strukturave.
- Rritja e numrit të komunave përtej numrit 30, psh ndarja e tyre, por kjo do të kishte shumë pasoja. Por për t'i bërë këto propozime na duhet një analizë e asaj çfarë po ndodhë në nivelin lokal, por poashtu të ftojmë shoqërinë civile të spjegojë se çfarë duhet të ndodhë në nivelin lokal.

## TRI ÇËSHTJET KRYESORE

Kjo tryezë u fokusua në tri çështje mbi reformën e qeverisjes lokale:

- Transferi i kompetencave,
- Implikacionet ekonomike dhe financiare, dhe
- Marrëdhëniet ndëretnike

Këto u shqyrtuan në dy seancat e fundit të ditës së parë dhe veçmas në grupet punuese në ditën e dytë.<sup>3</sup>

## DEBATI

### A siguron 2000/45 “pruarjen e qeverisjes më afër popullit”?

Disa zyrtarë nuk ishin të pajtimit të mirren para sysh çfarëdo ndryshime të 2000/45. Me gjithë mospajtimet e dukshme me këtë rregullore, një zyrtarë i qeverisë nuk ishte i pajtimit për ndryshimin e saj dhe ishte i prirur

<sup>3</sup> Për një përmbledhje të prezentimeve të ndryshme, shih përmbledhjet e të gjitha punimeve në fund të raportit.

t'a sheh ate në një mënyrë fleksibile kështu që ajo siguron "pruarjen e qeverisjes afër popullit" të nevojshme. Është interesant të vërehet se megjithë kritikën e gjërë ndaj 2000/45, shumë kosovarë dolën në mrojtje të saj kur u ballafaquan më mundësinë e hyrjes në një fazë të cilën ata nuk do t'a kontrollonin.

#### Sa veta duhet të përfaqësohen nga një anëtar i kuvendit komunal?

Derisa në Kuvendin Komunal të Prishtinës, një anëtar kuvendi përfaqëson zërin e 10,000 qytetarëve, një anëtar kuvendi nga Novobërda përfaqëson vetëm 300 qytetarë. Cila është madhësia ideale për Kosovën?

#### Konsolidimi i qeverisë qendrore para dërgimit të pushtetit tek qeveria lokale?

Kjo ka qenë një kritikë e cituar shpesh nga pjesëmarrësit kosovarë. Sidoqoftë, një këshilltar i PSSP-së u përgjegj se "fushat kryesore të cilat i kërkon qeveria janë çështjet themelore të UNMIK-ut: ministria e brendshme, e punëve të jashtme dhe e drejtësisë. Asnjë nga këto nuk ka të bëjë me qeverisjen lokale. Ky është një mit që duhet të mundohemi t'a mënjanojmë". Në nivelin lokal, ajo e pranoi se komuniteti ndërkombëtarë nuk duhet të mbajë pushtete ekzekutive. "Gati gjithçka është transferuar dhe personeli i UNMIK-ut duhet të mësojë se roli i tyre është këshilldhënës", shtoi ajo.

#### IMPLIKIMET FINANCIARE

Konferenca e vuri në pah mungesën e madhe të ekspertizës financiare sa i përket pasojave që do t'i kishte Kosova nëse çfarëdo reforme do të ndërmerrej. Kishte disa brenga të ndryshme në këtë aspekt. Një ishte përmendur nga një ekonomist nga një institut i pavarur, që tha se "nuk mund të decentralizojmë deri në pikën ku do të rrezikonim strategjinë e zhvillimit të përgjithshëm makroekonomik (Isa Mustafa).

Një pjesë e madhe e debatit poashtu u fokusua në korelacionin në mes madhësisë së komunave dhe mundësive të tyre financiare. Një pjesëmarrës ndërkombëtarë vërjeti se 46% e komunave në Slloveni kishin më pak se 5000 banorë. "Madhësia e komunave është shumë e madhe në Kosovë", tha ai. Paevitueshëm, diskutimi përfshinë listën e kompetencave, politikat e personelit, kapacitetet e resurseve humane në terren dhe një numër çështjesh tjera.

Kryesuesi i një institucioni ekonomik kosovar përgjegjës për privatizimin tërhoqi vërejtjen "se çfarëdo që japim ne, do të varet nga justifikimi ekonomik i këtyre modeleve". Ai tha se qëndrueshmëria ekonomike duhet të jetë kriteri kryesorë në zgjedhjen e një modeli. Ai mori shembujt e ish-Jugosllavisë (der në të shtatëdhjetat) dhe të Rusisë si modele shumë të centralizuara, dhe të Edvard Kardeljit pas të shtatëdhjetave si shumë të decentralizuar, duke thënë se të dytë kolapsuan, pasi që nuk ishin të qëndrueshëm ekonomikisht. Ai poashtu kundërshtoi disa të dhëna tjera të paraqitura nga pjesëmarrës tjerë, duke thënë "nëse e përjashtoni Prishtinën he katër qendra tjera urbane, Kosova ka një sistem më të copëzuar se Sllovenia apo Hungaria. A dëshironi t'a arsyetoni atë me figura apo përmes efektivitetit ekonomik?"

#### NDIKIMI I MARRËDHËNIEVE NDËRETNIKE NË QEVERISJEN LOKALE

Përfaqësuesi i Drejtoratit për Qeverisje Lokale nga Ministria e Shërbimeve Publike filloi duke prezentuar çfarë është bërë deri më tani në aspektin e marrëdhënieve ndëretnike. Të gjitha komunat kanë formuar dy komisione (për ndërmjetësim dhe për komunitete). Të gjitha kanë formuar zyra lokale që janë struktura paralele të shtetit. Struktura të ndryshme komunale kanë dedikuar një pozitë zëvendësi për minoritetet.

Në të njëjtën kohe, ai i denoncoi komunat në veri si paralele dhe që nuk kanë asgjë të përbashkët me pjesën tjetër të Kosovës (duke përfshirë etiketën e ndërtesës). E tërë organizata është e bazuar në ligjin komunal të Serbisë. Ai përfundon se problemi është jo se ky grup etnik ndjehet si minoritet, por se ky është në esencë një problem politik. Prandaj, nuk është çështje e decentralizimit por e interesave politike. Decentralizimi do të kishte efekt vetëm në rrethanat ku serbët do të ndjeheshin se po krijojnë institucione publike të përbashkëta. Një pjesëmarrës ndërkombëtarë u përgjegj, "Ne duhet të shohim nëse ka arsye të brendshme në Kosovë që e promovojnë ekzistimin e institucioneve paralele".

Kryetari i një komune serbe në jug të Kosovës poashtu bëri me dije se nevoja e institucioneve paralele nuk ishte vetëm politikë por shpesh e ndërlidhur me tranzicionin. Sektori publik në ish Jugosllavi ishte tmerrësisht më i madh në krahasim me atë që ofron Kosova sot nën menaxhimin ndërkombëtar. Derisa komuna e tij kishte 150-200 punëtorë shëndeti të punësuar, bugjeti i Kosovës siguron vetëm 44. Një situatë e ngjashme ekziston edhe në sektorin e arsimit, ku nevoja për rroga të dyfishta është shumë e nevojshme.

Pasi që decentralizimi ishte inicuar në relacion me Mitrovicën përpara zgjedhjeve, komponenti etnik i debatit është madhor. Sidoqoftë, pjesëmarrësit gatë universalisht u pajtuan se decentralizimi nuk duhet të bëhet duke u bazuar në kriterin etnik. Kjo ishte kundër filozofisë së Kornizës Kushtetuese, dhe Karta Europiane për Vetë-Qeverisje nuk e definon etnicitetin si kriter për këtë nivel të rregullimit të qeverisjes. Sidoqoftë, faktori etnik duhet të mirret para sysh për arsytet në vijim: (a) për të forcuar pozitën e komuniteteve etnike (korniza kushtetuese është një shembull) mjetet e tyre për të luftuar për interesat e tyre, (b) është me rëndësi që të mendohet për nivelin e tretë (fshatrat lokale ku një komunitet etnik dominon) që ato të formojnë nën-njësinë e tyre, (c) komisionet e komuniteteve si një instrument shumë i mirë që duhet të zhvillohet. Është shumë e rëndësishme që të kemi garanca dhe instrumente të kornizës së sundimit të ligjit për të luftuar për të drejta individuale dhe grupore të komuniteteve etnike (Ombudspersoni, ligji suprem apo mekanizma tjerë që mund të dalin në të ardhmen). Një ekspert tjetër ndërkombëtarë poashtu e theksoi forcimin e mjeteve politike dhe instrumenteve ligjore të minoriteteve për të qenë në gjendje që ti mbrojnë të drejtat e tyre brenda kornizës ekzistuese në komuna të ndryshme. Krijimi i nën-njësiive duhet të konsiderohet si një mjet i mundshëm për të siguruar përfaqësim më të madh të të gjitha pakicave në fusha të caktuara si një rrugë për të mirëmbajtur të drejtat e komuniteteve etnike si kultura dhe gjuha.

Folës tjerë komentuan se decentralizimi i shtyrë etnikisht do t'i ndante komunitetet edhe më tej. Një pjesëmarrës ndërkombëtarë u përgjegj se decentralizimi nuk ishte çështje e ndarjes së njerëzëve, por e sjelljes së qeverisë më afër popullit, rritjes së përfaqësimit demokratik dhe rritjes së legjitimitetit demokratik të qeverisë. Duke e ndërlidhur argumentin e qëndrueshmërisë ekonomike dhe etnicitetit, ai tha, “një diktaturë mund të jetë shumë më e lirë se demokracia, por kjo nuk do të thotë se është më e mirë”.

Një lider lokal nga Prizreni theksoi se edhe pse Kosova ka mekanizma demokratik nuk është ende ploëtsisht demokratike pasi që ekziston trashëgëmia e së kaluarës dhe kjo nuk ndryshon brenda ditës. Ai po ashtu tha se privilegjet e mbajtura krijojnë sensin e pabarazisë sot. Në këtë aspekt, ai preferoi të diskutohet kjo temë si marrëdhënie në mes shumicës dhe pakicës, dhe e para shpesh mund të shihet si kërcënuese, edhe kur nuk është. Ai tregoi tregimet e suksesit në Prizren, ku ai vetë si Kryetar thotë se ka arritur 70% të të hyrave financiare. Në zonat me pakica me status të varfër social, komuna nuk ka kërkuar nga komuniteti për të mbledhur fonde për infrastrukturën, por ka ndihmuar me fonde të veta apo ka kërkuar fonde nga jashtë. Ai i përmendi dy mekanizmat që i kanë përdorur për mbrojtjen e pakicave, Komisionin e Komuniteteve dhe Komisionin për Ndërmjetësim.

Një ekspert akademik nga rajoni e paraqiti modelin e Lijphartit ku elitat politike të grupeve të ndryshme janë gati për dialog dhe kompromis, ka sistem proporcional zgjedhor, forma të ndryshme të vetë-qeverisjes lokale dhe rajonale mbi baza territoriale (të drejtat individuale), duke përfshirë pushtete vetoje të pakicave në nivelin lokal me qëllim të mbrojtjes së identitetit të tyre kulturor.

Si të shkohet para me analizimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe qeverisjes lokale? Një ekspert rajonal sygjeroi si në vijim:

- 1). Relevanca e marrëdhënieve ndëretnike për reformën e qeverisjes lokale
- 2). Idetë dhe klasifikimi i problemeve
- 3). Instrumentet: institucionet dhe procedurat

Kjo do të dilte me një katalog problemesh dhe propozimesh.

#### **Disa vërejtje relevante:**

- (a) Disa pjesëmarrës kosovarë konkluduan se *një reformë gjithëpërfshirëse nga e cila do të përfitonte e gjithë popullata, pa marrë para sysh origjinën etnike, do të ishte shumë e shtrenjtë dhe e mundshme vetëm me ndihmë nga Europa*. Njëri nga ata pyeti nëse Europa është gati të bëjë një plan të llojit të Marshallit për t'u marrë me mungesën e kohezivitetit në rajon.
- (b) *Pakicat jo-serbe theksuan se aspektet kulturore, arsimore dhe gjuhësore duhet të respektohen derisa shprehën pakënaqësi me fokusin aktual mbi dimensionin konfliktual si vetëm shqipëtar/serb*. Një zyrtarë nga pakicat në Prizren u shpreh kundër decentralizimit sipas kritereve etnike.
- (c) Një ekspert rajonal sygjeroi një *administratë me katër shtresa*: gjithë-Kosovare, rajonale, komunale dhe nën-komunale. Kjo ishte kundërshtuar më herët nga pjesëmarrësit kosovarë si ekonomikisht e paqëndrueshme. Ky ekspert poashtu bëri një propozim konkret rreth Mitrovicës, për të krijuar një asociacion të komunave: Jugu, Veriu dhe Zveçani.

#### SYGJERIMET PËR HULUJMTIME TË PARAQITURA NË TRYEZË TË RRUMBULLAKËT

- (d) Një zyrtar kosovar kërkoi që të bëhet hulumtim *mbi performansën e komunave deri më tash* (në komunat etnikisht homogjene shqipëtare dhe serbe si dhe në ato të përziera);
- (e) Njëri nga organizatorët lokal mendoi se duhet të ketë hulumtime *mbi funksionimin dhe statusin ligjor të njësive nën-komunale*.
- (f) Të bëhet hulumtim *mbi atë se cilat përgjegjësi që tash i kanë niveli qendror dhe lokal do të mund të dorëzoheshin tek nivelet më të ulëta*.
- (g) Një tjetër pyetje ishte *se a janë të gatshme për transfer të kompetencave*. Derisa komunat shpesh retorikisht kërkojnë më shumë kompetenca, një zyrtarë ndërkombëtarë tha në realitet ato nuk janë duke kërkuar. U vu në pah se duhet të analizohet kapacitetin e vërtetë dhe gatishmërinë për të ndërmarrë përgjegjësi më të mëdha. Në këtë kontekst, disa komuna u vlerësuan si jo të gatshme, siq është Dragashi që nuk e kishte konstituuar qeverinë komunale derisa të tjerat ishin më të pasura dhe më mirë sa i përket kapacitetit të resurseve humane dhe kështu kërkohet më shumë përgjegjësi.
- (h) Kryerja e *një analize raportuese komparative të bugjetit për të gjitha komunat*.
- (i) Ne kemi nevojë për *disa hulumtime empirike; pritjet e popullit; poashtu cilat janë idetë e komunave mbi atë se si mund të bëhet transferimi*.

#### SYGJERIMET

- Një pikë startimi do të ishte të përpilohet një ligj mbi qeverisjen lokale.
- Një komision për t'i harmonizuar të gjithë tekstet ligjore
- Futja në një plan të llojit të Marshallit pa ndonjë kohezivitet në rajon?
- Mitrovica do të mund të organizohet si një asociacion i tri komunave (një ekspert nga rajoni)
- Rajoni mikro-europian. Katër mikro-rajone: (a) Mitrovicë + Sanxhak (Novi Pazar dhe Bijelo Polje), (b) Gjilan, Preshevë, Kumanovë, (c) Kukës, Prizren, Tetovë, (d) Pejë, Kelmend, Plavë (një ekspert nga rajoni)
- Komunë e qytetit për Mitrovicën (një ekspert nga rajoni)
- Një kampanjë agresive e mediave, apo një seri tryezash për të diskutuar që edhe decentralizimi që përfshin një formë të aspektit etnik është në interes të shumicës (Pozhidaev)
- Një status të veçantë komunal për Prishtinën (Brand)
- E drejta e vetos mbi disa çështje të rëndësishme për identitetin nacional (Janjić)
- Krijimi i një grupi punues: Ne jemi duke shkuar para me hapa të kujdesshëm. Mendoj se një rezultat shumë i mirë i kësaj konferencë është të shihet kompleksiteti që e kemi përpara. Me qëllim që të ndihmotet ky debat, ne duhet të krijojmë një grup punues të bartësve kryesorë dhe ne mund të punojmë së bashku në përgatitjen e konferencës së ardhshme.

#### PROJEKTET HULUMTUESE TË SYGJERUARA

1. Analizimi i performansës komunale duke u mvarur në ndarjen etnike të legjislaturës (komunat e përziera, serbe, shqipëtare)
2. Çfarë po ndodhë me të vërtetë në nivelin komunal? Ekziston nevoja të analizohet se çfarë po ndodh në nivelin lokal? Analizimi i situatës në terren: një mision i gjetjes së fakteve mbi atë se si kanë punuar deri tash niveli komunal dhe nën-komunal. Si funksionojnë asociacionet e fshatrave?
3. Krucialja: studimi i situatës së komunave, dhe si duhet të shpërndahen kompetencat. Le të bëhet ajo nga homologët tanë lokal. Kjo duhet të jetë relevante veçanërisht për Asociacionin.
4. A janë gati nivelet më të ulëta?



5. Kemi nevojë për disa hulumtime empirike; pritjet e popullit; cila është ideja e komunave mbi atë se si duhet të bëhet devolucioni; vlerësimi i opsioneve të Marcusit së bashku me disa parametra tjerë (ekonomikë, demokratikë, përputhshmëria me ligjet e Këshillit të Europës); kjo merr shumë resurse dhe kohë.

## PROFILI I PJESEMARRËSËVE

Pjesëmarrësit përfshinë: Ministrin e Shërbimeve Publike, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Kryesuesi i OMIK-ut, këshilltar i Kryeministrit, kryesues nacional i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, këshilltar i PSSP-së, Kryesuesi i Drejtoratit për Qeverisje Lokale, Kryesuesi i grupit parlamentar të Koalicionit “Kthimi”, tre kryetarë komunash (një serb), kryesuesi i Asociacionit të Komunave, ekspertë të lartë rajonal (dy nga Serbia, njëri nga t'a përpiluesi origjinal i planit për decentralizim të Qendrës për Koordinim), një ekspert i lartë nga Austria, delegacioni i Këshillit të Europës në Kosovë, kryesuesi i zyrës së GNK-së në Kosovë, një analist programi nga UNDP, disa OJQ lokale dhe rajonale. Përveç përfaqësuesëve serbë, pakicat përfaqësuan komunitetin turk dhe romë-ashkali-egjiptian.

## SHTOJCA I: PËRMBLEDHJE TË ZGJEDHURA TË PUNIMEVE TË PREZENTUARA<sup>4</sup>

### Jakup Krasniqi, Ministër i Shërbimeve Publike

#### Rreth Qeverisjes Lokale në Kosovë

Shënime nga përvoja në terren:

##### *Vërejtje pozitive*

- Rezultate të rëndësishme në **institucionalizimin dhe funksionalizimin** e qeverisjes lokale në Kosovë
- Vlerësim i përgjithshëm se 2000/45 siguron ca **zgjidhje të avansuara të përputhshme me ato të vendeve me praktikë të avansuar të qeverisjes lokale**

##### *Vërejtje negative:*

- Shumë pjesë të 2000/45 nuk janë të definuara mirë, kontradiktore me njëra tjetrën dhe shpesh të pamundura për t'u implementuar
- Nuk ka mekanizma tjerë që do të siguronin një definim më të mirë ligjor të raporteve (**dhe autonominë e qeverisjes lokale**) në mes qeverisjes lokale dhe asaj qendrore, duke përfshirë UNMIK-un. Psh shumë funksione janë marrë nga rregullore të mëvonshme, kontradiktat në mes 45/2000 dhe 49/2000

##### *Syjerime:*

- Miratimi i Ligjit mbi Qeverisje Lokale

#### **Sa i përket decentralizimit**

##### *Kundër:*

- Jo për derisa nuk është e qartë se cilat kompetenca i ka qeverisja qendrore. Kjo iniciativë është e nxituar dhe nuk është studiuar me mjaft kujdes.
- Parakusht: transfer i plotë i pushteteve tek institucionet qendrore që po krijohen, sipas Kornizës Kushtetuese
- Të folurit për decentralizimin tash për tash është një humbje kohe dhe largim vëmendjeje nga çështjet prioritare që kanë të bëjnë me konsolidimin dhe funksionalizimin e autoriteteve qendrore.
- Mënzrë në të cilën është paraqitur deri më tash, është krejtësisht e bazuar në kritere etnike dhe nuk mbështet involvimin e mëtejshëm të pjesëtarëve të minoriteteve në jetën institucionale në Kosovë. Si i tillë, ai është kundër Kartës Europiane për Vetë-Qeverisje (4.3). Prandaj rrjedhin kriteret: qëndrueshmëri ekonomike, karakteri gjeografik dhe demografik dhe sjellja e shërbimeve më afër qytetarëve.

##### *Argumentet:*

- 2000/45 veçmë u siguron komunave mundësinë për të dërguar disa nga përgjegjësitë e tyre në nivele

---

<sup>4</sup> Punimet janë në dispozicion në librarinë e KIPRED-it. Disa punime poshtu mund të jenë në dispozicion edhe elektronikisht.

më të ulëta

*Sygjerimet:*

- aktivizimi i zyrove lokale në “bashkësi lokale” (dhe nëse ka nevojë rritja e numrit të këtyre zyrove)

*Kusht:*

- çfarëdo ndryshimi administrativ i ri duhet të kalojë nëpër Kuvendin e Kosovës

*Plani për veprim:*

- Rishikimi i Kornizës Kushtetuese
- Reformimi i sistemit gjyqësor të përgjithshëm të Kosovës
- Përpilimi i një ligji mbi qeverisjen lokale

### **James Wooster, Ushtrues u detyrës Sekretar Permanent, Ministria e Financave dhe Ekonomisë**

Prezentim mbi Financat dhe buxhetimin komunal.

Shënime:

Granti i arsimit më i madhi për 2003

Të hyrat vetjake të komunave janë në 20%

### **Marcus Brand, Analist i ESI, MBI KOMUNËN JUGOSLLAVE**

Marcus Brand presentoi disa aspekte të situatës komunale në Kosovë, duke përfshirë një analizë të bekgraundit të komunës jugosllave prej komunave të pas-luftës-së-dytë-botërore. Brand presentoi një shikim historik të pas luftës së dytë botërore të sistemit të komunave në Kosovë. Ai e theksoi ndryshimin e “komiteteve lokale të popullit” (që ekzistuan nga 1946 deri 1951) në komuna (nga 195 më 1952 në 82 më 1955 dhe në 29 prej 1959) kur Kardelj themeloi sistemin e qeverisjes lokale që e trashëgon sot ish Jugosllavia. Pasi që distriktet administrative ishin zhdukur, Komuna “u bë njësi kyqe e autoritetit lokal dhe gëzoi, pas kushtetutës së 1953, të gjitha pushtetet e qeverisjes përveç atyre të caktuara për federatën dhe republikat” (Brand 3). Komuna ishte komuniteti bazik socio-politik dhe kishte pushtete shumë më të mëdha se sa komunat normalisht kanë sot në Përfundim.

Komunat jugosllave ishin krijuar si njësi bazike socio-territoriale me atributet ideologjike. Këto njësi bazike nuk ishin qeveri lokale në sensin klasik, por ato ekzekutonin funksione të shtetit. Komunat ishin krijuar për të bashkuar funksione lokale dhe shtetërore, por në të njëjtën kohë, çështjet e pastra lokale nuk ishin prioriteti i këtyre komunave. Deri më 1974, këto komuna ekzekutonin 3000 detyra të ndryshme, 80% prej tyre funksione shteti të decentralizuara. Pas shkatërrimit të Jugosllavisë, Sllovenia bëri një ndarje shumë të qartë të koncepteve të çështjeve të qeverisjes lokale, dhe në anën tjetër rezervoi qeverisjen e decentralizuar të shtetit për një numër zyrash shtetërore.

Komuna jugosllave:

-detyrat (shumica ishin detyra shtetërore): kompetente për t'i kryer të gjitha punët publike në territorin e saj;

-pasi që pushtetet e tyre u muarën dhe komunat u dobësuan, hapësira e tyre territoriale mbeti kryesisht e njëjtë.

#### Mbijetesa komunale e Kosovës në vitet 1990ta

Kosova në të nëntëdhjetat kishte një sistem të ri të komunave (numri dhe territori i komunave mbeti i pandryshuar). Në kohën menjëherë pas luftës, niveli lokal ishte improvizuar. Kjo më vonë ishte përqaftuar nga administrata ndërkombëtare ku kishte kontinuitet në kuptimin e roleve dhe funksioneve të tyre nga sistemi i vjetër e jo nga ajo që Serbia kishte paraqitur në të 1990tat. Këto 30 komuna filluan të operojnë dhe t'a reformojnë veten në mungesë të një mendimi qendror se si të reformohen ato. Kjo shtyrë ndarjen e komunave (nga UNMIK-u) ashtu siq ishin lënë nga të pesëdhjetat në pozitë të tyre. Komunat kanë formësuar një trashëgimi të fortë institucionale në mendjet e njerëzëve, mbase poashtu me kuptimin e opsioneve dhe përgjegjësi. Përpara, këto ishin përgjegjëse për çdo gjë në nivelin lokal. Kjo gjithçka-përgjegjësi (kompetencë gjenerale) është diçka që nuk vjen vetëm nga sistemi i vjetër komunist, por poashtu i riparaqit më 1999, por poashtu nëse e shihni 2000/45 si ligj komunal zyrtar që u paraqit më 2000.

#### Rregullorja 2000/45 dhe më tej

Nëse shihet më afër Rregullorja 2000/45 që ishte ende referenca kryesore për qeverisje lokale, nuk është e qartë kush ishte autoriteti qendror. Në të njëjtën kohë, komunave u ishte dhënë një përgjegjësi e përgjithshme

për çdo çështje që nuk është e rezervuar për ndonjë autoritet tjetër (Seksioni 2.1); Seksioni 3 definon përgjegjësitë përkundër pushteteve, derisa Seksioni 4 deklaron se komunat kanë të drejtë të nxjerrin rregullore lokale komunale lidhur me çështje brenda kompetencave të komunës.

Marrëdhënia në mes autoritetit qendror dhe komunave mbetet e paqartë. Kjo rregullore nuk e definon nëse roli i administratorëve komunal, që ishin paraqitur shumë para 2000/45, është lokal apo janë përfaqësues të nivelit qendror. Ata kanë funksione të mbikëqyrjes përveç administrimit. Shpejt mbas 2000/45, kjo ishte pranuar dhe 2000/45 shihej gjithnjë e më shumë si një mjet fillestar e jo si një ligj komunal që do të ishte baza për vitet në vijim.

Brand poashtu theksoi se shumica e përgjegjësive që fillimisht u ishin dhënë komunave u ishin marrë pastaj nga rregullore tjera, prandaj, edhe nëse vazhdojmë dhe e implementojmë plotësisht, por duke pasur para sysh të gjitha rregulloret tjera, nuk mbetet shumë për komunat. Në anën tjetër komunat shpesh fajësohen për çështje jashtë jurisdiksionit të tyre. “Në mënyrë paradoksale, komunat fajësohen për pasaportat, por nuk janë përgjegjësi e tyre” (Brand).

Të përfshira:

Një hartë e komunave të Kosovës të vitit 1960.

Pjesë nga Gerskovic mbi sistemin e komunave në ish Jugosllavinë

Kushtetutën e Republikës së Serbisë, të 28 Shtatorit 1990

### **Mustafa, Isa “Një vlerësim dhe rekomandime të RIINVEST-it lidhur me rolin e qeverisjes lokale në zhvillimin ekonomik”**

Disa konkluzione:

- Administrata publike nuk është reformuar mjaft

Disa sfida mbi të cilat qeverisja lokale mund të ketë ndikim:

- Promovimi i procesit të privatizimit
- Decentralizimi i vendimmarrjes tek qeverisja lokale dhe autonomia financiare për institucionet lokale
- Relaksimi i rregulloreve në disa fusha si dhe bërja e rregulloreve më të thjeshta për qytetarët e thjeshtë
- Transformimi i organizatave publike dhe efikasiteti i tyre (reagime proaktive ndaj nevojave dhe kërkesave publike)
- Reformimi i autorizimeve, menaxhimit të resurseve humane dhe menaxhimit financiar me qëllim që të bëhen më efektive për funksione të pavarura dhe ndër-qeveritare
- Zhvillimi i rrugëve të reja të bashkëpunimit me sektorin privat dhe shoqërinë civile

Konkluzione të mëtejme

- Probleme të mëdha lokale për shkak të nivelit të lartë të shkatërrimit në disa zona. Kjo poashtu shoqërohet me një nivel të ulët të kapacitetit menaxherial dhe institucional për t'u ballafaquar me këto sfida. Problemi më i madh është varfëria dhe papunësia
- Përmirësimi i qeverisjes lokale jashtë Prishtinës do të lehtësonte presionin mbi Prishtinën ku vlerësohet se jeton 23% e popullatës së Kosovës
- Performansat e komunave duhet të ndërliken me preferencat politike lokale

Propozimet

- Strategji e qëndrueshme zhvillimore në përputhshmëri me resurset lokale në dispozicion dhe rrethana tjera (invollvimi i qeverisjes lokale në krijimin e kushteve të mira për bizneset lokale)
- Përmirësimi i menaxhimit të brendshëm të strukturave lokale qeveritare (buxhetimi, financat publike, legjislacion, menaxhim i shërbimeve publike dhe planifikimi strategjik)
- Definim i kompetencave të organeve qendrore dhe lokale me qëllim për të qenë në gjendje për t'i definuar më mirë financat publike në Kosovë

Në përgjithësi, Kosova ka nevojë për reformë të qeverisjes lokale, duke përfshirë disa elemente të decentralizimit (fiskal poashtu), sidoqoftë ende duke i ruajtur mekanizmat makroekonomik që sigurojnë një strategji të përgjithshme zhvillimore.

### **Dušan Janjić “Qeverisja lokale dhe marrëdhëniet ndëretnike: Rasti i Mitrovicës si një “pikë e nxehtë”**

Ky punim e shikon rastin e Mitrovicës në fundin e vitit 2002 dhe strategjinë e UNMIK-ut në prekjen dhe lansimin e decentralizimit. Punimi bën një analizë politike të ngjarjeve dhe një vlerësim të këtyre ngjarjeve për procesin e përgjithshëm të reformës së qeverisjes lokale.

Disa citime:

- “Edhe vetë Steiner nuk ishte shumë i brengosur për bojkotin (e zgjedhjeve lokale nga banorët e Mitrovicës veriore), për shkak se ia bëri të mundur atij të implementojë një pjesë të Planit të tij, që të ngadalësojë diskutimin mbi decentralizimin si dhe të dal jashtë diskutimit të decentralizimit duke ia lënë atë Këshillit të Europës” (1);
- “Në situatën e ditëve të sotme, duhet të dizajnohet në suaza reale dhe të sinkronizohet *procesi i devolucionit të pushteteve*, që tani janë të centralizuara në Kosovë në nivelin e UNMIK-ut” (5);

Propozimet

- Krijimi i formave të vetëqeverisjes së komuniteteve:
  - Këshilli i Komunitetit dhe
  - Unioni i Komunitetit (kompetencat e sygjera të këtyre dy organizmave janë paraqitur në faqet 5-6)
- Krijimi i një Euro rajoni (6-7)

### **Ali Sadriu, Ministër i Ekonomisë dhe Financave (MEF)**

Rezultatet deri më tash:

- 2002 – Viti i komunave
- MEF u fokusua në dy drejtime
  - Mbledhja e tatimit në pronë
  - Marrja e përgjegjësisë financiare

Më tej:

- MEF do të ndihmojë komunat me qëllim që të ngritet kapaciteti i tyre me qëllim që të marrin përgjegjësi financiare në vitin 2003, si një hap i rëndësishëm në institucionalizimin e reformës ekonomike dhe financiare në nivelin e qeverisjes lokale

### **Jovan Komšić “Marrëdhëniet në mes qeverive qendrore dhe lokale”**

Profesori Komšić bëri një analizë akademike të modeleve të ndryshme, duke mbrojtur një model konsociacional për nivelin komunal dhe rajonal në Kosovë. Ai i definon disa nga konceptet dhe problemet siq diskutohen në teori, si dhe ofron një analizë teorike të llojeve të ndryshme të mundshme të decentralizimit. Ai analizon koncepte si korelacioni në mes decentralizimit dhe efikasitetit, dekoncentrimi, decentralizimi administrativ, autonomia nga një pikëpamje ligjore dhe sociopolitike. Ai poashtu e shikon parimin e subsidiaritetit, menaxhimit të brendshëm të organizatës së qeverisjes lokale, regjionalizmin, si dhe përputhshmërinë me Kartën Europiane të Vetë-Qeverisjes.

## **SHTOJCA II**

BARTËSIT E PROCESIT

Këshilli i Europës, Misioni në Kosovë

Kuvendi i Kosovës/ Zyra e Kryetarit të Parlamentit

Qeveria e Kosovës/ Zyra e Kryeministrit

Administrata e UNMIK/Zyra e PSSP-së

Ministria e Shërbimeve Publike/Drejtorati i Qeverisjes Lokale

Ministria e Ekonomisë dhe Financave

OSBE, Misioni në Kosovë, Demokratizimi

Asociacioni i Komunave të Kosovës

## Instituti Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillime të Politikave

### LEXIME TË MËTEJME

Një numër punimesh janë dorëzuar para tryezës së rrumbullakët dhe janë shpërndarë. Një koleksion i madh i artikujve dhe librave është mbledhur nga KIPRED ndërkohë dhe është në dispozicion për përdorim nga ekspertët ndërkombëtarë dhe lokal të involvuar. Për resurse tjera, ne rekomandojmë të lexoni raportin nga takimi i parë, dhe punimin nga Marcus Brand. Ndërkohë, KIPRED është duke përgatitur një koleksion të të gjithë ligjeve të aplikueshme lidhje me qeverisjen lokale dhe duke bërë një hulumtim të kufizuar mbi organizimin nën-komunal.

Računsko Sodišče Republike Slovenije (25 Nov 2002). “Revizijsko poročilo o polovanju mestne občine Ptuj za leto 2001” Lubljana.

Stanovnik, Tine and Jože Sambt “Statusi aktual dhe shkalla e decentralizimit fiskal dhe rëndësia statistikave nënacionale në përgjithësi” Universiteti i Lubljanës, Fakulteti i Ekonomisë, Instituti i Statistikës (Rogaska Slatina, 21 June 2002).

LLA-ESI “Qeverisja dhe zhvillimi: Një tregim nga jeta e vërtetë e rritjes së sektorit privat në Bosne e Hercegovina” [Mësime nga Bosnia për Kosovën: Pjesa I] Lessons Learned and Analysis Unit-Pristina (13 Shkurt 2002).

### LIGJE RELEVANTE

UNMIK/REG/2000/45 (11 August 2000) MBI VETË-QEVERISJEN E KOMUNAVE NË KOSOVË

### DOKUMENTE RELEVANTE

RFJ/Qeveria e Serbisë et al (Nëntor 5, 2002). “Document mbi adminismin e pjesës veriore të Mitrovicës”

### HARTA

E komunave në Kosovë më 1965 “Opstine i srezovi u SFRJ: Politicko-Teritorijalna Poela – Stanje na dan 1.IV.1965”

Ministrstvo za notranje zadeve (1994) “Upravne enote v Republiki Sloveniji (58) s pripadajocimi obcinami” Urad za upravne notranje zadeve (1.1.1999).

### RESURSET E INTERNETIT NË SLOVENI

Uebfaqe e Ministrisë së Brendshme të Sllovenisë: [www.gov.si/loksam](http://www.gov.si/loksam)

[www.lokalna-samouprava.net](http://www.lokalna-samouprava.net)

[www.obcine.net](http://www.obcine.net)

### SHKURTESAT

KEVQ	Karta Europiane për Vetë-Qeverisje
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
DQL	Drejtorati për Qeverisje Lokale (brenda MSHP)
KiE	Këshilli i Europës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
RAE	Rom-Egjiptian-Ashkali
AKM	Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit

### LISTA E PJESËMARRËSËVE

**Abdullah Qafani**, Përfaqësues i RAE komuniteteve

**Agim Paca**, Ministria e Shërbimeve Publike, Këshilltar i Ministrisë

**Ahmet Shala**, Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit, Zëvendës Drejtor Menaxhues

**Aleksandar Popov**, Qendra për Regjionalizëm, Drejtor

**Bernard Zeneli**, KIPRED; UP, Shef i Departmentit të Shkencave Politike

**Besnik Tahiri**, OMIK, Demokratizimi, Asst. Oficer i Programit

**Bilall Sherifi**, Ministria e Shërbimeve Publike, Këshilltar

**Dmitry Pozhidaev**, UNMIK, Zëvendës Administrator i Komunës së Prishtinës  
**Dragan Smiljanović**, NDI, PPP DEP  
**Dragana Antić**, Komuna e Shtërpçës, Shef i Kabinetit  
**Dragiša Krstović**, Koalicioni “Povratka”  
**Enver Hasani**, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Profesor  
**Ercan Şpat**, Komuna e Prizrenit, Nën-Kryetar  
**Franklin De Vrieze**, OSBE Demokratizimi, Lider Ekipi  
**Friedhelm Frischenschlager**, OMIK, Drejtor i Demokratizimit  
**Gianfranco D’eramo**, OSBE Demokratizimi, ECSP  
**Hafeez Ur Rehman**, DLA/ MPS, Këshilltar i Lartë Ndërkombëtar  
**Hysni Bajrami**, RISHP, Drejtor  
**Isa Blumi**, NYU/KIPRED, ABD/PhD  
**Isa Mustafa**, Riinvest, Zëvendës Drejtor  
**Ivo Sanc**, KiE – KiEDMK, ekspert  
**Jakup Krasniqi**, MSHP, Ministër  
**Jennifer Slotin**, UNDP, Analist i Programit  
**Jonathan Browning**, OSBE, ZD  
**Jovan Komšić**, Profesor  
**Kevin Deveaux**, NDI, Këshilltar Ligjor  
**Leon Malazogu**, KIPRED, Drejtor i Programit  
**Lulzim Peci**, KIPRED/KCSF, Drejtor Ekzekutiv  
**Lutfi Haziri**, AKK, PMASS Gjilan/Kryetar i AKK  
**Marcus Brand**, ESI, Analist  
**Pascal Fieschi**, OMIK, Kryesues i Misionit  
**Ramush Rexhaj**, MEF, Këshilltar  
**Sejdi Osmani**, Riinvest, Drejtor Administrativ  
**Sladjan Ilić**, Komuna e Shtërpçës, Kryetar  
**Sven Lindholm**, OSBE, Zëvendës Zëdhënës  
**Val Percival**, GNK, Drejtoreshë  
**Valentin Mitev**, OSBE, PO/TL